

4 MARS 2015

Deklarata kontraverse e Ministrit Murati dhe reagimet që pasuan

Ministri i Diasporës, Valon Murati, së fundmi është bërë cak i kritikave pasi kishte lidhur migrimin ilegal nga Kosova me pozitën e “privilegjuar” të komuniteteve pakicë në Kosovë. Gjatë një ligjerate para studentëve të një universiteti private më 26 shkurt lidhur me çështjen e migrimit ilegal të shtetasve të Kosovës drejt Bashkimit Evropian, z. Murati duke iu referuar dispozitave kushtetuese që garantojnë të drejtat e komuniteteve, është cituar të ketë thënë se “Ekziston një marrëdhënie shumë problematike me pakicën serbe. Kushtetuta jonë është gjithashtu problematike sepse iu jep pakicave një pozitë të privilegjuar”, dhe se “nuk mund ta ndërrojmë kushtetutën pa votat e dy të tretave të pakicave në Kuvend”.¹ Murati gjithashtu ishte cituar të ketë thënë se “kjo është një prej arsyeve kryesore për migrimin ilegal të shtetasve të Kosovës”.² Ministria e Diasporës, në anën tjetër, ka theksuar se deklarata e ministrit Murati “është nxjerrur jashtë kontekstit”. Ministria më tej shpjegoi se edhe pse është e saktë që ministri ka thënë se komunitetet janë të privileguara në Kosovë sa i përket të drejtave kushtetuese, ai gjithashtu ka thënë se kjo nuk është arsyeja kryesore pse shqiptarët po e lëshojnë Kosovën, po vetëm “një nga arsyet”, përveç mungesës së sundimit të ligjit, dhe zhvillimit të dobët socio-ekonomik në vend.³

Deklarat e z. Murati u mbuluan gjerësisht nga mediat dhe u dënuan nga Këshilli Konsultativ për Komunitete (KKK), një organ qeveritar që sjell së bashku përaqësues të shoqërisë civile të gjithë komuniteteve jo-shumicë në Kosovë. Këshilli i quajti deklaratat e z. Murati “të paqëndrueshme” dhe shtoi se nuk i kontribuojnë marrëdhënieve ndër-etnike, e aq më pak zgjidhjes së problemik aktual të migrimit ilegal.⁴

Kritikat më të ashpra erdhën nga një rrjet i OJQ-ve dhe individëve që përfaqësojnë komunitetin serb në Kosovë, nën ombrellën e Rrjetit Strategjik Aksional Kosovor (“Kosovo Policy-Action Network” ose K-PAN). Me anë të një deklarate për media, K-PAN kërkoi që qeveria të kërkojë falje dhe që z. Murati të jipte dorëheqje. K-PAN gjithashtu vlerësoi se “deklarata të tilla nga zyrtarë të lartë të qeverisë shpalosin cinizmin dhe hipokrizinë e elitave politike në Prishtinë kur është fjala për angazhimin e tyre për ndërtimin e një shoqërie shumë-etnike, dhe se frika e komunitetit serb dhe ajo e komuniteteve tjera është e arsyeshme sa i përket shkeljes së të drejtave të tyre të garantuara.” Gjithashtu, K-PAN vlerësoi deklaratë si “një lloj presioni nga Prishtina e cila e bën të qartë se nuk do të tërhiqet nga pozicionet e saja maksimaliste në kuadër të dialogut në Bruksel, që nuk lejon hapësirë për kompromis sa i përket Asociacionit të Komunave me shumicë serbe themelimi i së cilës po prolongohet.” Në fund, K-PAN e quajti deklaratën e z. Murati “shumë të rrezikshme dhe vazhdimësi e praktikës së mirë-krijuar për të fajësuar komunitetin serb për të gjitha dështimet e elitës politike në Prishtinë”, duke theksuar se kjo mund të shpie deri ti “mobilizimi i

¹ Shih këtu <http://koha.net/?id=27&l=46460> ose <http://www.balkaninsight.com/en/article/kosovo-serb-ngos-call-for-removal-of-albanian-minister-1>

² <http://koha.net/?id=27&l=46460>

³ Deklaratë e z. Lorik Pustina, Drejtor për Komunikim dhe Udhëheqës i Departamentit për Informim Publik në Ministrinë e Diasporës dhënë ECMI Kosovës, 3 Mars 2015.

⁴ <http://www.ccc-rks.net/index.php/lajme-sq/item/204-komunikate-per-shtyp-27-shkurt-2015>

njerëzve përgjatë vijave etnike.” Në këtë drejtim, ata kërkuan që “manipulimi me pakënaqësitë e komunitetit shumicë me situatën e tanishme socio-ekonomike dhe artikulumit i saj nëpërmjet nxitjes së ndarjeve etnike nga ana e elitave politike në Prishtinë të ndalohej”.⁵

Pavarësisht motiveve dhe kontekstit në kuadër të së cilës është dhënë kjo deklaratë e z. Murati, ECMI Kosova beson fuqishëm që deklaratat që bëjnë ndërlidhjen e situatës së përgjithshme të rëndë socio-ekonomike me “pozitën e privilegjuar” të komuniteteve, dhe në veçanti të atij serb, kontribuojnë në nxitjen e jotolerancës ndër-etnike në Kosovë. Aktualisht marrëdhëniet ndër-etnike mes komunitetit shqiptar dhe atij serb janë mjaft të tensionuara, në veçanti në nivel politik, pas shkarkimit të ish-ministrit për komunitete dhe kthim Aleksandar Jablanović. Duke marrë parasysh protestën e heshtur të Listës serbe, që momentalisht gjindet jashtë qeverisë së Kosovës, së bashku me pakënaqësinë e vazhdueshme të elitës dhe popullit në Kosovë me përzjerjen e qeverisë së Serbisë në çështje shtetërore në Kosovë, është mëse e qartë që deklarata të kësaj natyre nuk kontribuojnë në përmirësimin e marrëdhënieve ndër-etnike dhe mirëkuptimit në Kosovë. Të drejtat e komuniteteve janë të përcaktuara në Kushtetutë dhe sigurojnë një kornizë ligjore dhe mekanizma mbrojtës që garantojnë integritimin e tyre në shoqërinë e Kosovës; ato i plotësojnë të drejtat e gëzuara nga të gjithë shtetasit e Kosovës e nuk i lëjnë në hije ato. Për më tepër, ne nuk shohim lidhjen direkte mes të drejtave të komuniteteve të garantuara me Kushtetutë dhe migrimin ilegal të shtetasve të Kosovës drejt BE-së, veçanërisht ngaqë migrimi ilegal nuk është i kufizuar tek shqiptarët por ka prekur të gjitha komunitetet e Kosovës.⁶ Në përmbledhjen e politikave *Farkimi i një mjedisi të punës në Qeverinë e Kosovës*, ECMI Kosova ka elaboruar për nevojën e Qeverisë së Kosovës për të nxitur dhe krijuar një marrëdhënie të punës dhe për nevojën që zyrtarët publik që të mbajnë parasysh natyrën e rolit të tyre në qeveri në çështjet e ndjeshme që kanë të bëjnë me marrëdhëniet ndër-etnike.

Dënimi publik i deklaratave të z. Murati është veprimi i parë i këtij lloji që është ndërmarrë nga ana e përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile në Kosovë. Megjithatë është për të u lavdëruar fakti që organizatat e shoqërisë civile serbe kanë marrë pozitën e tyre si mbikëqyrës të punës së partive politike dhe qeverisë, ekziston rreziku që këto organizata të përfshihen në konfrontimin politik përgjate vijave etnike që komplikoi punën e qeverisë së Kosovës që prej formimit të saj në dhjetor të vitit 2014. Shoqëria civile duhet të vazhdojë të mbajë pozicionin e saj të një sfere të dialogut dhe angazhimit konstruktiv ndërmjet komunitetit shqiptar dhe atij serb, dhe nuk duhet të jetë një shesh i zgjeruar i konfrontimeve politike.

Për më shumë informacion ju lutem na kontaktoni në + 381 (0) 38 224 473, apo përmes e-mail-it: info@ecmikosovo.org

⁵<http://koha.net/?id=27&l=46460>; http://www.b92.net/info/komentari.php?nav_id=962689.

⁶ Shih përmbledhjen e politikave të ECMI Kosovës që analizon emigrimin në rritje të komuniteteve rom, ashkali, dhe egjiptiane këtu: <http://www.ecmikosovo.org/?p=5847>

Raporte dhe analiza të tjera politike:

[Asociacioni/Komuniteti i komunave me shumicë serbe – shumë spekulime, pak marrëveshje faktike dhe mos-zbatim](#)

Shkurt 22, 2015

[Sistem gjyqësor dhe juridik u unifikuar në Kosovë?](#)

Shkurt 13, 2015

[Çfarë duhet të mbahet mend nga rasti Jablanović?](#)

Shkurt 8, 2015

[Thirrje për Arsyë dhe Veprim pas protestave në Prishtinë](#)

Janar 25, 2015

[Farkimi i një ambienti të punës në kuadër të Qeverisë së Kosovës](#)

Janar 19, 2015

[ECMI Kosova dënon bllokadën e dhunshme të hyrjes në Kishën Ortodokse Serbe në Gjakovë ECMI](#)

Janar 7, 2015

[Përmbledhje politike: Formimi i Qeverisë së re të Kosovës, Përfaqësimi i komuniteteve pakicë dhe Sfidat që dalin përpara](#)

Dhjetor 10, 2014

[Buletin Informativ i ECMI Kosovës – Një vështrim mbi situatën e fundit të sigurisë në Kosovë](#)

Nëntor 4, 2014

[Përmbledhje e shkurtër e ECMI Kosovës mbi Zhvillimet Politike në vend: Komunitetet pakicë dëshirojnë të shohin fundin e ngërçit politik](#)

Tetor 23, 2014

[Partitë politike të minoriteteve në mjedisin politik në ndryshim e sipër në Kosovë](#)

Korrik 31, 2014

[ECMI Kosova bën thirrje për qetësi pas përshkallëzimit të tensioneve etnike pas ndeshjes kualifikuese në futboll midis kombëtareve të Serbisë dhe Shqipërisë](#)

Tetor 15, 2014

[Komunikatë për shtyp - Ndërlidhja e ndarjes: Krijimi i një Bordi të Përbashkët për qytetin e Mitrovicës](#)

Qershor 27, 2014

[Zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë: Një Shikim i Çështjeve, sfidave dhe skenës politike në prag të zgjedhjeve të 8 qershorit](#)

Qershor 2, 2014

Rreth ECMI Kosovës

ECMI Kosova është organizata kryesore joqeveritare e angazhuar me çështje të komuniteteve minoritare në Kosovë, me qëllim të zhvillimit të institucioneve përfshirëse, përfaqësuese dhe të ndjeshme ndaj komuniteteve, institucione këto që mbështesin një Kosovë të qëndrueshme shumë-etnike. ECMI Kosova kontribuon në zhvillimin, forcimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës, dhe përkrah institucionalizimin e mekanizmave qeveritarë të ndërlidhur me çështje të komuniteteve, dhe ngrit kapacitetet e akterëve të shoqërisë civile dhe të qeverisë për t'u angazhuar me njëri-tjetrin dhe bashkëpunuar në mënyrë konstruktive dhe të qëndrueshme.